



**VENDIM**

**Nr. 70, Datë 27.05.2016**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E PLANIT TË  
INVESTIMEVE PËR VITIN 2016 PËR KOMPANINË OSHEE SH.A**

Ne mbështetje të neneve 16; 20, gërmat “a” dhe “e”; 75; 110, pika 2 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe nenit 25 të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 21, date 18.03.2009; “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin Nr. 62, datë 15.09.2009; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 27.05.2016, mbasi shqyrtoi relacionin “Për fillimin e procedurave për miratimin e Planit të Investimeve për vitin 2016 për kompaninë “OSHEE”sh.a, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për miratimin Planit të Investimeve për vitin 2016 për kompaninë “OSHEE”sha.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**